

VENDIM
Nr. 199, datë 2.4.2014

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 88 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën 1 “Rregullorja model e planifikimit”, seksioni 2 “Rastet e zbatimit, kushtet dhe rregullat e përdorimit të kësaj rregulloreje”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 480, datë 22.6.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 4, shtohen shkronjat “d” dhe “e”, me këtë përmbajtje:

“d) Zhvillimin e strukturave me funksion prodhues, industrial, përfshirë këtu edhe ato me material porositës, ndërtime të mbështetura nga programe kombëtare investimesh, prodhimi, përpunimi dhe distribucionesh bujqësore e blegtorale të ndryshme.

e) Lejet e ndërtimit për kategoritë e përcaktuara në këtë nen, edhe nëse janë në zonat e pezulluara, jepen nga bashkitë dhe komunat, por pasi të jetë shprehur më parë AKPT-ja dhe duke vënë në dijeni Këshillin Kombëtar të Territorit për konformitetin e lejes me instrumentet kombëtare dhe/ose vendore të planifikimit të miratuara ose në proces.”.

2. Procedurat e hollësishme për zbatimin e këtij vendimi përcaktohen me udhëzim të ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

3. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në nenet 5 e 12 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet për 6 (gjashtë) muaj nga hyrja në fuqi të tij.

KRYEMINISTRI
Edi Rama